



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Nr. 320-4287/21

Klinë, me 08.02.2021

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e kulturave perimore (ngritja e serrave me sistemin e ujitjes pik-pik).

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë– kulturës së perimtarisë, Komuna e Klinës respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural publikon :

THIRRJE PUBLIKE

Ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e ngritjes së serrave në sipërfaqe prej 50 m² deri 100 m². Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj me:

- Financim 70 % të kostos së serrës
- Këshillime profesionale dhe monitorim të vazhdueshëm të fermerëve përmes ekspertëve të kësaj drejtorie.

Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë banor i komunës së Klinës;
2. Të posedoj sipërfaqe tokësore të mjaftueshme për vendosjen e serrës;
3. Të ketë mundësi ujitje për serrë;
4. Të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30% të mjeteve financiare në koston e serrës;
5. Përparësi kanë fermerët nga zonat rural dhe ata të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë nga projektet e komunës – DBPZHR.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e plotësuar nga fermeri, e cila merret në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës;
2. Fleta poseduese;
3. Kopja e letërnjoftimi.

Afati i aplikimit nga data 08.02.2021 deri me 19.02.2021

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

DREJTORI i DBPZHR

Naser Morina

